



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 07.02.2019

VENDIM

Nr. 10, datë 07.02.2019

**PËR ÇELJEN E POSAÇME TË KURSEVE NË PROGRAMET E STUDIMIT NË
UNIVERSITETIN 'ISMAIL QEMALI' VLORE**

Në mbështetje të nenit 3, pika 2, shkronja a, nenit 38, pika 1, shkronja a në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 45 në Rregulloren e Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, si dhe në përgjigje të kërkesës së Departamentit të Biznesit, nr. 24, datë 17.01.2019, Senati Akademik në mbledhjen e datës 07.02.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë çeljen e posaçme të kurseve një herë në vit, brenda dyfishit të kohës normale të studimit, me kërkesë të studentit, në rastet kur:
 - a. lënda nuk ofrohet më si pasojë e ndryshimeve në program në zbatim të ligjit, VKM-ve dhe udhëzimeve përkatëse.
 - b. programi i studimit nuk është çelur në vitin akademik respektiv.
 - c. raste të tjera të pamundësisë së marrjes së kurseve.
2. Modalitet për mënyrën e organizimit të këtyre kurseve dhe trajtimi i rasteve shqyrtohen dhe përcaktohen nga dekanati.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland Zisi

